



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.16, datë 23/05/2005

**“MBI DISA NDRYSHIME NE V.K.B NR.18, DT.26/04/2004 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.18, dt.26/04/2004, vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.7, dt.21/03/2005 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.5,dt.27/02/2003 ”Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave vendore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.51, dt.03/11/2004 “Për delegimin e disa kompetencave Njësive Bashkiake të qytetit të Tiranës”, dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Në kapitullin III “Organizimi i Administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore” pika 3 “Drejtor Njësie” **shfuqizohet**.
2. Në kapitullin IV.2 “Marrëdhëniet me Këshillin Bashkiak” rrjeshti i dytë, shprehja (... në fushën e tregjeve ...) **shfuqizohet**.
3. Në kapitullin V “Aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore”, pas pikës a “Mbledhja e taksave dhe tarifave vendore”, **pika b “Administrimi dhe mirëmenaxhimi i tregjeve publike” shfuqizohet**.
4. Në kapitullin V, pika 3 “Në fushën e tregjeve” **shfuqizohet**.
5. Në kapitullin V, nënkapitulli V.1 “Struktura e Administratës së Drejtorisë”, pika 3 “Drejtoria e Administrimit të Tregjeve (me sektorët përkatës)”, **zëvendësohet** me “Drejtoria e Administrimit Financiar (me sektorët përkatës)”, ndërsa pika 4 “Njësia e Administrimit Financiar” **shfuqizohet**.
6. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.
7. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI